



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05/R001

Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës

Vendosi: Paneli i përbërë nga Gjykatësi i Vetëm

Gjykatës Zhilber Biti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 korrik 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Pagimin e Kamatës nga Salih Mustafa në lidhje me Zhdëmtimet

T'i njoftohet:

Zyrës Administrative
Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Salih Mustafës
Julius von Bone

Mbrojtjes së Viktimave
Ani Pues

GJYKATËSI I VETËM¹ lëshon këtë Vendim për Pagimin e Kamatës nga Salih Mustafa në lidhje me Zhdëmtimet.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 6 prill 2023, pasi e shpalli Salih Mustafën (z. Mustafa) fajtor për krime lufte,² Trupi Gjykses I lëshoi një urdhër për zhdëmtim kundër tij, me të cilin e urdhëroi që t'u paguante tetë (8) viktimave shumën e gjithsejtë prej 207.000 eurosh si kompensim për dëmin e shkaktuar nga krimet për të cilat u shpall fajtor (Urdhri për Zhdëmtim).³ As z. Mustafa, as Mbrojtja e Viktimave, nuk e apeluan Urdhrin për Zhdëmtim.
2. Më 14 dhjetor 2023, një Panel i Dhomës së Gjykatës së Apelit la në fuqi të gjitha verdiktet e fajësisë mbi të cilat bazohet Urdhri për Zhdëmtim.⁴
3. Më 19 janar 2024, Mbrojtja e Viktimave i kërkoi Gjykatësit të Vetëm t'i caktonte z. Mustafa një afat për pagimin e zhdëmtimeve të akorduara viktimave dhe nënvizoi më tej rëndësinë e pagimit të kamatëvonesës ligjore mbi shumat për t'u paguar për zhdëmtim.⁵ Z. Mustafa nuk dorëzoi përgjigje.

¹ KSC-BC-2020-05/R001, F00002, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, [Decision Assigning a Single Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm) 17 janar 2024, publik; F00024, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, [Decision Assigning a Single Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm), 18 shkurt 2025, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00494, Trupi Gjykses I, *Aktgjykim*, 16 dhjetor 2022, konfidencial, para. 831. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 8 qershor 2023, [F00494/RED3/COR](#).

³ KSC-BC-2020-05, F00517, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Zhdëmtim Kundër Salih Mustafës*, 6 prill 2023, konfidencial, para. 250-252, 283, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Version i Korrigjuar i Versionit Publik të Redaktuar të Urdhrit për Zhdëmtim u lëshua më 14 prill 2023, [F00517/RED/COR](#).

⁴ KSC-CA-2023-02, F00038/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Appeal Judgment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit), 14 dhjetor 2023, publik, para. 481.

⁵ KSC-BC-2020-05/R001, F00003, Mbrojtja e Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtjes së Viktimave për Caktimin e Datës për Pagimin e Zhdëmtimeve* (Kërkesa e Mbrojtjes së Viktimave) 19 janar 2024, konfidenciale, para. 7(c). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 26 shkurt 2024, F00003/RED. *Shih gjithashtu* F00010, Mbrojtja e Viktimave, *Përgjigje e Mbrojtjes së Viktimave ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim* (Përgjigja e Mbrojtjes së Viktimave), 28 shkurt 2024, konfidencial, para. 15-17. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 4 prill 2024, F00010/RED.

4. Më 25 mars 2024, Gjykatësi i Vetëm lëshoi Vendimin mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Viktimave për Caktimin e Datës për Pagimin e Zhdëmtimeve dhe Çështje të Tjera (Vendimi mbi Pagimin e Zhdëmtimeve).⁶ Duke konstatuar se Urdhri për Zhdëmtim tashmë ishte i formës së prerë dhe i zbatueshëm me efekt të menjëhershëm, Gjykatësi i Vetëm trajtoi, ndër të tjera, edhe aspektin e kamatës mbi shumat e zhdëmtimeve, dhe (i) urdhëroi Administratoren t'i kërkonte informacion Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës në lidhje me ligjin dhe praktikën e zbatueshme në gjykatat e Kosovës për: (a) kamatën që zbatohet kur akordohen zhdëmtime për dëme të pësuar, mbi bazën e një verdikti penal të formës së prerë, dhe (b) kur fillon llogaritja e kamatës në rast të çështjeve të tilla para gjykatave në Kosovë; dhe, rrjedhimisht, (ii) shtyu marrjen e vendimit mbi këtë aspekt.⁷ Gjithashtu, Gjykatësi i Vetëm e udhëzoi Administratoren që: (i) ta informonte z. Mustafa për modalitetet e pagesave që ai mund të ishte i gatshëm të bënte mbi bazë vullnetare për të përmbushur detyrimet e tij ndaj viktimave dhe t'i raportonte Gjykatësit të Vetëm nëse z. Mustafa ishte pajtuar të bënte ndonjë pagesë apo nëse kishte deklaruar synimin për ta bërë këtë; dhe (ii) të kryente vlerësimin e mjeteve financiare së z. Mustafa, për të vlerësuar nëse mjetet e disponueshme aktuale dhe të ardhshme të tij – pasi janë marrë parasysh nevojat e familjes së tij – do t'i mundësonin të paguante plotësisht zhdëmtimet e urdhëruara brenda një afati të arsyeshëm.⁸ Gjykatësi i Vetëm urdhëroi gjithashtu që zhdëmtimet për viktimat të paguheshin nga pasuria e z. Mustafa, duke mundësuar kështu zbatimin e pjesshëm të Urdhrit për Zhdëmtim.⁹

⁶ KSC-BC-2020-05/R001, F00012, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Viktimave për Caktimin e Datës për Pagimin e Zhdëmtimeve dhe Çështje të Tjera*, 25 mars 2024, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar konfidencial dhe *ex parte* u dorëzuan më të njëjtën ditë, F00012/CONF/RED dhe F00012/CONF/RED2. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 22 korrik 2024, [F00012/RED](#).

⁷ Vendimi mbi Pagimin e Zhdëmtimeve, para. 28-29, 52, 66(a), (o).

⁸ Vendimi mbi Pagimin e Zhdëmtimeve, para. 30-31, 58, 66(m).

⁹ Vendimi mbi Pagimin e Zhdëmtimeve, para. 39-45, 66(c), (g).

5. Më 10 maj 2024, Administratorja e informoi Gjykatësin e Vetëm se z. Mustafa kishte refuzuar të plotësonte formularin e deklarimit të mjeteve financiare, që Administratorja ia kishte dhënë për ta plotësuar në kuadër të vlerësimit të mjeteve financiare, dhe parashtroi se, në mungesë të formularit të deklarimit, procesi i vlerësimit të mjeteve financiare së z. Mustafa do të ishte shumë më i ndërlikuar.¹⁰ Për këtë arsye, ajo i kërkoi Gjykatësit të Vetëm të urdhëronte z. Mustafa të plotësonte formularin e deklarimit të mjeteve financiare dhe të jepte informacionin e kërkuar.¹¹

6. Më 29 maj 2024, Administratorja i raportoi Gjykatësit të Vetëm se nuk kishte marrë përgjigje nga z. Mustafa sa i përket kryerjes së pagesave për viktimat mbi bazë vullnetare dhe dorëzoi informacionin e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me kamatën për shumat e zhdëmtimeve (informacioni i Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës).¹² As z. Mustafa, as Mbrojtja e Viktimave nuk dorëzuan përgjigje.

7. Më 19 korrik 2024, Administratorja informoi Gjykatësin e Vetëm se urdhri i tij në lidhje me pagimin (e pjesshëm) të zhdëmtimeve për viktimat ishte zbatuar dhe dorëzoi një tabelë me shumat që u ishin paguar viktimave mbi bazë proporcionale.¹³

¹⁰ KSC-BC-2020-05/R001, F00014, Administratorja, *Kërkesë e Administratores për Urdhër drejtuar z. Mustafa për Bashkëpunim në Vlerësimin e Mjeteve financiare* (Kërkesa e Administratores për Urdhër), 10 maj 2024, konfidenciale dhe *ex parte*, para. 10-12, me Shtojcat 1-2, konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 25 tetor 2024, F00014/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 mars 2025, F00014/RED.

¹¹ Kërkesa e Administratores për Urdhër, para. 13.

¹² KSC-BC-2020-05/R001, F00016, Administratorja, *Raport i Administratores për Zbatimin e Vendimit dhe të Urdhrave lidhur me Zhdëmtimet (F00012)* (Raporti i Administratores), konfidencial dhe *ex parte*, 29 maj 2024, para. 17-21, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, Shtojcat 5, 7, konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 6, konfidenciale. Versionet e redaktuara konfidenciale dhe *ex parte* u dorëzuan më 3 qershor 2024, F00016/CONF/RED, dhe F00016/CONF/RED2. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 mars 2025, F00016/RED. *Shih gjithashtu* Shtojcën 6 të Raportit të Administratores. Shtojca 6 e Raportit të Administratores u riklasifikua si publike më 18 mars 2025.

¹³ KSC-BC-2020-05/R001, F00017, Administratorja, *Raport Shtesë i Administratores për Zbatimin e Vendimit dhe Urdhrave lidhur me Zhdëmtimet (F00012)*, konfidencial dhe *ex parte*, 19 korrik 2024, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 mars 2025, F00017/RED.

8. Më 18 shtator 2024, Gjykatësi i Vetëm lëshoi Vendimin mbi Kërkesën e Administratores për Urdhër drejtuar z. Mustafa për Bashkëpunim, me të cilin e urdhëroi atë të plotësonte pa vonesë formularin e deklarimit të mjeteve financiare në kuadër të kryerjes së vlerësimit të mjeteve financiare dhe ndryshoi afatin për dorëzimin e raportit të Administratores lidhur me vlerësimin e mjeteve financiare së z. Mustafa.¹⁴

9. Më të njëjtën ditë, Gjykatësi i Vetëm mbajti shënim njoftimin e paraqitur nga një prej viktimave për heqje dorë nga marrja e pagesave në zbatim të Urdhrit për Zhdëmtim¹⁵ dhe vendosi që asaj viktime nuk do t'i bëhej asnjë pagesë në zbatim të Urdhrit për Zhdëmtim.¹⁶

10. Më 13 dhjetor 2024, Administratorja informoi Gjykatësin e Vetëm se nuk kishte marrë formular të deklarimit të mjeteve të plotësuar nga z. Mustafa.¹⁷

11. Më 16 dhjetor 2024, bazuar në kërkesën e Administratores,¹⁸ Gjykatësi i Vetëm lëshoi një vendim në të cilin: (i) konstatoi se z. Mustafa ishte në shkelje të një urdhri

¹⁴ KSC-BC-2020-05/R001, F00018, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kërkesën e Administratores për Urdhër drejtuar z. Mustafa për Bashkëpunim*, 18 shtator 2024, konfidencial dhe *ex parte*, para. 8, 10, 13(a), (f). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më të njëjtën ditë, F00018/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 15 prill 2025, F00018/RED.

¹⁵ KSC-BC-2020-05/R001, F00015/RED, Mbrojtja e Viktimave, *Version i Redaktuar Publik i Njoftimit të Mbrojtjes së Viktimave për Heqje Dorë nga Pagesa e Zhdëmtimit nga [REDAKTUAR]*, 17 mars 2025, publik. Versioni origjinal konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 15 maj 2024, F00015. Gjithashtu, u dorëzua edhe versioni i redaktuar konfidencial, më 17 mars 2025, F00015/CONF/RED.

¹⁶ KSC-BC-2020-05/R001, F00019/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Njoftimin e Mbrojtjes së Viktimave për Heqje Dorë nga Pagesa e Zhdëmtimit nga [REDAKTUAR]* (Vendimi F00019), 3 prill 2025, publik. Versioni origjinal konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 18 shtator 2024, F00019. Gjithashtu, u dorëzua edhe versioni i redaktuar konfidencial, më 3 prill 2025, F00019/CONF/RED.

¹⁷ KSC-BC-2020-05/R001, F00022, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në lidhje me Urdhrin F00018*, 13 dhjetor 2024, publik, para. 5.

¹⁸ KSC-BC-2020-05/R001, F00020/RED, Administratorja, *Version i Redaktuar Publik i Kërkesës së Administratores për Urdhra drejtuar [REDAKTUAR] në kuadër të Vlerësimit të Mjeteve financiare*, 10 korrik 2025, publik. Versioni origjinal konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte* u dorëzuan më 10 tetor 2024, F00020. Versioni i redaktuar konfidencial dhe *ex parte* dhe versioni i redaktuar konfidencial u dorëzuan më 14 mars 2025, F00020/CONF/RED, dhe F00020/CONF/RED2.

gjyqësor të mëparshëm, për arsye se kishte refuzuar të plotësonte formularin e deklarimit të mjeteve financiare dhe se kishte refuzuar në mënyrë të përsëritur të ndërmernte veprime në dobi të viktimave në përmbushje të detyrimeve të tij sipas Urdhrit për Zhdëmtim; (ii) lëshoi disa urdhra për të mundësuar kryerjen e vlerësimit të mjeteve financiare të z. Mustafa; dhe (iii) ndryshoi *proprio motu* afatin për dorëzimin e raportit të Administratores mbi vlerësimin e mjeteve financiare të z. Mustafa.¹⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Gjykatësi i Vetëm mban parasysh nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Kushtetuta) dhe nenet 3(2), 7, dhe 22 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji).

III. DISKUTIM

A. PARASHTRIME

1. Mbrojtja e Viktimave

13. Së pari, Mbrojtja e Viktimave argumenton se caktimi i afatit për pagimin e zhdëmtimeve nga z. Mustafa është me rëndësi kritike për llogaritjen e kamatëvonesës ligjore që duhet të paguhet në të ardhmen mbi shumat e zhdëmtimeve, që do të duhet të bazohet në afatin përkatës.²⁰

14. Së dyti, ndonëse Mbrojtja e Viktimave pranon se pagimi i kamatëvonesës ligjore mbi shumat për t'u paguar mund të shihet si aspekt hipotetik në këtë fazë, kur është

¹⁹ KSC-BC-2020-05/R001, F00023/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Refuzimin e Salih Mustafës për të Përmbushur Detyrimet e Tij në Bazë të Urdhrit për Zhdëmtim dhe mbi Kërkesën e Administratores për Urdhra drejtuar [REDAKTUAR] lidhur me Vlerësimin e Mjeteve financiare*, 15 korrik 2025, publik, para. 10-12, 15-18, 23. Versioni origjinal konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, u dorëzua më 16 dhjetor 2024, F00023. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar konfidencial dhe *ex parte* u dorëzuan më 19 shkurt 2025, F00023/CONF/RED, dhe F00023/CONF/RED2.

²⁰ Kërkesa e Mbrojtjes së Viktimave, para. 7(c); Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 15.

ende e paqartë nëse shuma e borxhit kryesor do të paguhet, dhe sa prej saj do të paguhet, ajo thekson se kamata është e rëndësishme për të siguruar që zhdëmtimet e akorduara të mos zhvlerësohen ekonomikisht me kalimin e kohës. Sa i përket kamatëvonesës ligjore për t'u zbatuar, Mbrojtja e Viktimave i referohet nenit 382 të Ligjit nr. 04/L-077 të Kosovës për Marrëdhëniet e Detyrimeve²¹ (Ligji i Kosovës për Detyrimet), ku përcaktohet një kamatëvonesë prej tetë për qind (8%) në vit.²²

2. Informacioni i Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës

15. Së pari, lidhur me kamatën për t'u zbatuar në rastet e akordimit të zhdëmtimeve në bazë të një vendimi penal të formës së prerë, Ministria e Drejtësisë e Kosovës informon se: (i) ky aspekt nuk ishte i rregulluar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, por gjykatat e Kosovës kishin vendosur një kamatëvonesë që pranohej nga bankat në Kosovë në mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar, nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata deri në pagesën definitive; dhe (ii) që nga hyrja në fuqi e Ligjit të Kosovës për Marrëdhëniet e Detyrimeve më 20 dhjetor 2012, lartësia e kamatëvonesës u përcaktua në tetë për qind (8%) në vit.²³

16. Së dyti, në lidhje me pyetjen se kur fillon llogaritja e kamatëvonesës në raste të tilla në gjykatat e Kosovës, Ministria e Drejtësisë e Kosovës bën dallimin midis dëmit material dhe jomaterial (moral) dhe informon se kamata fillon të llogaritet që nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë për të parin, dhe që nga momenti i marrjes së ekspertizës për të dytin.²⁴ Ministria e Drejtësisë e Kosovës citon gjithashtu nenin 357 të Ligjit të Kosovës për Detyrimet, ku përcaktohen afate parashkrimi për kërkesat për zhdëmtim, konkretisht tre (3) vjet nga data kur pala e dëmtuar ka marrë dijeni për

²¹ Shpallur me Dekretin nr. DL-024-2012, të datës 30 maj 2012, dhe botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 16, 19 qershor 2012.

²² Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 16-17.

²³ Shtojca 6 e Raportit të Administratores, f. 3

²⁴ Shtojca 6 e Raportit të Administratores, f. 3

dëmin dhe për personin që ka shkaktuar dëmin, ose, në çdo rast, kërkesa parashkruhet për pesë (5) vjet nga shkaktimi i dëmit.²⁵

B. KONSTATIM

17. Fillimisht, Gjykatësi i Vetëm rikujton se, ndonëse pranoi rëndësinë e kamatës së mundshme mbi shumat për t'u paguar nga z. Mustafa, në Vendimin mbi Pagimin e Zhdëmtimeve Gjykatësi i Vetëm konstatoi se kjo çështje qartësisht nuk ishte urgjente, meqenëse nuk ishte e qartë nëse dhe kur do të paguheshin ato shuma dhe, rrjedhimisht e shtyu marrjen e vendimit për këtë aspekt.²⁶

18. Gjykatësi i Vetëm vë në dukje gjithashtu se, deri më sot, Urdhri për Zhdëmtim nuk është zbatuar në tërësi dhe ende është e sigurt nëse dhe kur do të ndodhë kjo. Megjithatë, Gjykatësi i Vetëm pajtohet me Mbrojtjen e Viktimave se, parimisht, z. Mustafa duhet të paguajë kamatë mbi shumat e zhdëmtimeve që u detyrohet viktimave, për të siguruar që zhdëmtimet të mos zhvlerësohen ekonomikisht me kalimin e kohës.

19. *Korniza ligjore.* Gjykatësi i Vetëm vëren se Ligji dhe Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës nuk përmbajnë dispozita për kamatën që duhet zbatuar dhe për momentin kur fillon llogaritja e kamatës. Gjithashtu, Gjykatësi i Vetëm mban parasysh se legjislacioni i Kosovës të cilit i referohen Mbrojtja e Viktimave dhe Ministria e Drejtësisë e Kosovës, domethënë Ligji i Kosovës për Detyrimet, nuk është i përfshirë shprehimisht në Ligj dhe i zbatuar nga Ligji dhe, për këtë arsye, Dhomat e Specializuara (DHS) nuk kanë detyrimin të gjykojnë në përputhje me të.²⁷

²⁵ Shtojca 6 e Raportit të Administratores, f. 3.

²⁶ Vendimi mbi Pagimin e Zhdëmtimeve, para. 50-52, 66(o).

²⁷ *Shih* nenin 3(2)(c) të Ligjit.

20. Po kështu, sipas mendimit të Gjykatësit të Vetëm, informacioni i Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës nuk është i plotë, ose është i paqartë, sepse në të nuk jepet informacion për (i) kamatën që zbatohet nga gjykatat e Kosovës përpara hyrjes në fuqi të Ligjit të Kosovës për Detyrimet, ose (ii) bazën ligjore ku e mbështet informacionin e dhënë lidhur me momentin kur fillon llogaritja e kamatës.

21. Gjithashtu, Gjykatësi i Vetëm nuk arrin të kuptojë pse, kur përmend afatin e parashkrimit për kërkesat për zhdëmtim – një aspekt që nuk u ngrit nga Gjykatësi i Vetëm – Ministria e Drejtësisë e Kosovës përmend vetëm nenin 357 të Ligjit të Kosovës për Detyrimet, ndërkohë që anashkalon nenin 358, me titull “Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale”, i cili duket se është më relevant për rastin konkret dhe përcakton që: “kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”. Gjithsesi, duhet vënë në dukje se bazuar në juridiksionin kohor të DHS-së sipas nenit 7 të Ligjit, ndjekja penale e krimeve të luftës në DHS nuk ka afat parashkrimi dhe, rrjedhimisht, nuk ka afat parashkrimi për kërkesat për zhdëmtim për dëmet e shkaktuara nga këto krime në bazë të nenit 22 të Ligjit. Sido që të jetë, vendosja e kufizimeve kohore për ndjekjen penale të krimeve të luftës do të binte ndesh me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sidomos sa u përket detyrimeve në bazë të nenit 2 (e drejta për jetë) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut²⁸ dhe, rrjedhimisht, do të ishte në kundërshtim me nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës. Gjykatësi i Vetëm është i mendimit se i njëjti parim vlen edhe për kërkesat për zhdëmtim për dëmet e shkaktuara nga krime të tilla.

²⁸ European Court of Human Rights, *Aslakhanova dhe Others v. Russia*, nos. 2944/06, 8300/07, 50184/07, 332/08 dhe 42509/10, 18 December 2012, para. 237.

22. Për këto arsye, Gjykatësi i Vetëm konstaton se informacioni i Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës ka dobi të kufizuar në kuadër të këtij vendimi.

23. *Kamata.* Lidhur me kamatën që duhet zbatuar, Gjykatësi i Vetëm vëren se neni 382 i Ligjit të Kosovës për Detyrimet përcakton një kamatëvonesë prej tetë për qind (8%) në vit. Ndonëse, për arsyet e paraqitura në paragrafin 19 të këtij vendimi Ligji i Kosovës për Detyrimet nuk ka fuqi detyruese mbi të, Gjykatësi i Vetëm vëren sidoqoftë se kjo është kamata që normalisht z. Mustafa do të priste të paguante dhe që viktimat do të prisnin të paguheshin për vonesën në shlyerjen e çfarëdo detyrimi tjetër financiar që mund të paguhet në Kosovë. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh se korniza ligjore e DHS-së nuk përmban dispozita për këtë aspekt, Gjykatësi i Vetëm është i mendimit se, për arsye të parashikueshmërisë dhe sigurisë juridike dhe për mbrojtjen e interesave të viktimave, e njëjta kamatë duhet të zbatohet edhe për vonesat në zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kamata për t'u paguar nga z. Mustafa në këtë kuadër është tetë për qind (8%) në vit.

24. *Koha kur fillon llogaritja e kamatës.* Sa i përket momentit kur fillon llogaritja e kamatës, Gjykatësi i Vetëm mban parasysh se, në parim, kamata fillon të llogaritet që nga data kur duhet të bëhet pagesa, përveç nëse është kërkuar dhe miratuar shtyrja e afatit për fillimin e pagesës. Gjykatësi i Vetëm rikujton konstatimin e tij në Vendimin mbi Pagimin e Zhdëmtimeve, konkretisht se detyrimi i pagesës ka filluar që në momentin kur Urdhri për Zhdëmtim u bë i formës së prerë.²⁹ Ndonëse z. Mustafa mori njoftimin përkatës, ai nuk ka paraqitur parashtrime për këtë aspekt dhe nuk ka bërë kërkesë për shtyrje të afatit në lidhje me të. Rrjedhimisht, parimisht, pagimi i kamatës duhej të fillonte që prej momentit kur Urdhri për Zhdëmtim u bë i formës së prerë, që në këtë rast përkon me përfundimin e afatit për paraqitjen e apelit kundër Urdhrit për Zhdëmtim.

²⁹ Vendimi mbi Pagimin e Zhdëmtimeve, para. 28-29, 66(a).

25. Megjithatë, Gjykatësi i Vetëm gjykon se përcaktimi kur fillon llogaritja e kamatës në rastin aktual ka të bëjë edhe me aspekte të trajtimit të drejtë të z. Mustafa. Pa një kornizë ligjore (të qartë) apo vendim gjyqësor për kohën kur fillon llogaritja e kamatës përkatëse, Gjykatësi i Vetëm gjykon se në rastin aktual llogaritja nuk duhet të fillojë në qoftë se zotit Mustafa nuk i është dhënë mundësia, dhe deri sa t'i jepet mundësia, që të përmbushë Urdhrin për Zhdëmtim dhe të informohet si duhet se kur fillon llogaritja e kamatës përkatëse.

26. Aktualisht, Gjykatësi i Vetëm vëren se Mbrojtja e Viktimave ka paraqitur dy kërkesa për caktimin e kamatës me qëllim që të mbrohen të drejtat e viktimave, të cilave z. Mustafa nuk u është përgjigjur. Gjithashtu, zotit Mustafa i është dhënë mundësi e bollshme – më se një vit deri tani – për të përmbushur Urdhrin për Zhdëmtim, që ai ka refuzuar ta bëjë. Faktikisht ai nuk ka ndërmarrë asnjë hap për kompensimin e viktimave në këtë çështje gjyqësore. Për pasojë, ai nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas Urdhrit për Zhdëmtim.

27. Duke pasur parasysh faktorët e përmendur në paragrafin 19 më lart, si edhe vendimin e mëhershëm të Gjykatësit të Vetëm për të shtyrë marrjen e vendimit mbi kamatën dhe për të qenë i drejtë ndaj personit të dënuar/debitorit, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kamata duhet të fillojë të llogaritet vetëm që prej datës kur ky vendim t'i njoftohet zotit Mustafa.

28. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm informon z. Mustafa se, duke filluar nga data kur ai të njoftohet për këtë vendim, do të llogaritet një kamatë prej tetë për qind (8%) në vit, deri në përmbushjen e plotë të Urdhrit për Zhdëmtim.

29. *Llogaritja e kamatës.* Sa u përket modaliteteve të llogaritjes së kamatës të caktuar, Gjykatësi i Vetëm vendos se ajo do të zbatohet për pjesën e Urdhrit për Zhdëmtim që nuk është zbatuar ende, duke filluar nga data e njoftimit të këtij vendimi zotit Mustafa, dhe çdo vit më pas, më të njëjtën datë. Gjykatësi i Vetëm konstaton më tej se kamata

nuk duhet të përfshihet në shumën kapitale, domethënë, nuk duhet të llogaritet kamatë mbi kamatën e paguar më herët. Rrjedhimisht, kamata duhet të llogaritet veças nga pjesa e mbetur e Urdhrit për Zhdëmtim. Kamata duhet të paguhet vetëm në qoftë se dhe kur Urdhri për Zhdëmtim të zbatohet në tërësi dhe duhet të llogaritet mbi bazë proporcionale për secilën viktimë,³⁰ në përputhje me shumën e akorduar në Urdhrin për Zhdëmtim.

30. *Raportimi*. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Vetëm urdhëron Administratoren që – duke filluar një (1) vit nga data e njoftimit të këtij vendimi zotit Mustafa, dhe çdo vit më pas më të njëjtën datë, dhe mbi bazë konfidenciale në qoftë se është e nevojshme³¹ - të dorëzojë një raport vjetor ku të jepet, për secilën viktimë, (i) shuma që ka mbetur për t'u paguar nga z. Mustafa sipas Urdhrit për Zhdëmtim dhe, më vete, (ii) kamata për t'u paguar në përputhje me këtë vendim. Ky detyrim për raportim mbetet në fuqi deri në përmbushjen në tërësi të Urdhrit për Zhdëmtim dhe pagimin e plotë të kamatës mbi shumat e zhdëmtimeve të akorduara aty.

IV. VENDIM

31. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

- a. **KONSTATON** se Salih Mustafa nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas Urdhrit për Zhdëmtim;
- b. **INFORMON** Salih Mustafën se do të fillojë të llogaritet një kamatë prej tetë për qind (8%) në vit për pjesën e pazbatuar të Urdhrit për Zhdëmtim, duke filluar nga data kur atij do t'i njoftohet ky vendim; dhe

³⁰ Administratorja duhet të mbajë parasysh heqjen dorë nga pagesa e zhdëmtimit nga një prej viktimave (*shih* Vendimin F00019). *Shih gjithashtu* më lart, para. 9.

³¹ Në qoftë se Administratorja gjykon se informacioni duhet të dorëzohet si konfidencial, për të mbrojtur viktimat në këtë çështje gjyqësore, ajo duhet të dorëzojë njëkohësisht edhe versionin e redaktuar publik të tij.

- c. **URDHËRON** Administratoren që t'i dorëzojë Gjykatësit të Vetëm – duke filluar një (1) vit nga data e njoftimit të këtij vendimi zotit Mustafa, dhe më pas çdo vit më të njëjtën datë, mbi bazë konfidenciale në qoftë se është e nevojshme – një raport vjetor ku të jepet, për secilën viktimë, (i) shuma që ka mbetur për t'u paguar nga Salih Mustafa sipas Urdhrit për Zhdëmtim dhe, më vete, (ii) kamata për t'u paguar, sipas paragrafit 30 të këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti
Gjykatës i Vetëm

E mërkurë, 16 korrik 2025

Në Hagë, Holandë.